



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime
 - * Aktivitete tjera

Maj, 2017

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Krimet e luftës

Më 03-04 maj 2017, Akademia e Drejtësisë realizoi trajnimin me temë “Krimet e luftës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që përmes prezantimit të praktikave më të mira, diskutimeve dhe elaborimit të rasteve, të ngriten dhe avancohen njohuritë dhe kapacitetet profesionale të pjesëmarrësve në çështjet e hetimit dhe gjyqimit të rasteve të krimeve të luftës.

Ky trajnim ka trajtuar çështjet rreth hetimit dhe gjyqimit të rasteve të veprave penale të krimeve të luftës, përgjegjësia penale komanduese në rastet e krimeve të luftës si dhe hetimi dhe sigurimi i provave për krimet e luftës.

Gjatë këtij trajnimi gjithashtu u diskutuan çështjet që kanë të bëjnë me hetimin e krimeve të luftës sipas së drejtës ndërkombëtare penale, përgjegjësisë në të drejtën ndërkombëtare penale, pengesat dhe sfidat në fazën e hetimeve

dhe në fazën e grumbullimit të dëshmive dhe gjyqimit të këtyre veprave penale.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit diskutuan rastet nga praktika gjyqësore me fokus në shfrytëzimin e dëshmive, përkufizimin e tyre sipas kategorive, përzgjedhjen e caqeve, ndërtimin e rasteve dhe shfrytëzimin e dëshmitarëve.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë në hetimin dhe gjyqimin e krimeve të luftës.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë të nivelit themelor dhe policë hetues nga Policia e Kosovës.

Ky trajnim u realizua me mbështetjen e ekspertëve ndërkombëtar, prokurorë të EULEX të cilët u angazhuan në cilësi të trajnuesve.



Renta, llojet dhe caktimi i saj

Më 05 maj 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm, ka realizuar trajnimin me temë “Renta, llojet dhe caktimi i saj”.



Ky trajnim kishte për qëllim që gjyqtarët e fushës civile të avancojnë njohuritë e tyre lidhur me rentën dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore që lidhen me atë.

Në pjesën e parë të këtij trajnimi u trajtua kuptimi i rentës dhe kushtet që duhet të plotësohen për këtë kategori të dëmit dhe përfituesit e rentës. Ndërsa në pjesën e dytë të trajnimit, u trajtuan mënyrat e vlerësimit, caktimi i lartësisë dhe format e realizimit të rentës dhe raste nga praktika gjyqësore.

Gjithashtu gjatë trajnimit, u trajtua edhe zbatimi i drejtë i dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), që rregullojnë llojet e dëmit me theks të veçantë për rentën, kushtet që duhet të plotësohen për këtë kategori të dëmit, përfituesit e rentës, mënyrën e vlerësimit, caktimi i lartësisë dhe format e realizimit të rentës.

Tematika e shqyrtuar ishte me interes duke marr parasysh se në praktikën gjyqësore paraqiten kontestet e shpeshta për shkak të shpërblimit të dëmit dhe njëra prej kategorive të dëmit material është edhe renta. Renta si formë e shpërblimit të dëmit shpeshherë përbën sfidë për gjykatën në kuptimin e të vlerësuarit për nevojat e caktimit të rentës dhe në kuptim të caktimit të vëllimi të saj. Përveç kësaj, sfiduese paraqitet edhe mënyra e të provuarit dhe forma e caktimit të saj.

Në trajnim u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfitues ishin gjyqtarë të Gjykatës së Apelit, gjyqtarë të divizioneve civile të gjykatave themelore si dhe bashkëpunëtorë profesional.



Grupet e përbashkëta të hetimit

Më 10 - 12 maj 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin “Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtarë në Drejtësinë Penale” i financuar nga BE-ja, i zbatuar nga Rrjeti Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor, ka realizuar punëtorinë me temë “Grupet e Përbashkëta të hetimit”.

Qëllimi i punëtorisë ishte që t’iu mundësoj pjesëmarrësve të njohin kushtet ligjore të cilat duhet të plotësohen për arritjen e një marrëveshje mes dy e më shumë vendeve ose autoriteteve të tjera kompetente për hetimin e një veprë penale specifike.

Në sesionin e parë u elaboruan elementet bazë për grupet e hetimit, si parashihet elementi ndërkombëtar i një veprimtarie kriminale ndërkufitare, si përgatitet dhe nënshkruhet marrëveshja formale nga autoriteti kompetent, si bëhet hetimi i përbashkët, cilat janë metodat ekzistuese të hetimit të përbashkët, për të luftuar në mënyrë më efektive krimin e rëndë ndërkufitar si dhe mënyra e bashkëpunimit ndërkombëtarë më e shpejtë dhe më efikase ndërmjet autoriteteve të vendeve të ndryshme.

Në sesionin e dytë u elaborua elementi kohë i grupit të përbashkët të hetimit, krijimi i ekipit hetimor për një periudhë të caktuar kohore, masat e fshehta të kufizuara në kohë dhe për periudha të ndryshme kohore, pastaj si pasqyrohen këto kufizime në marrëveshjen për grupet e përbashkëta të hetimit si dhe plani operacional.

Po ashtu në këtë sesion u shtjellua edhe procedura hap pas hapi për krijimin e një grupi të përbashkët të hetimit, si bëhet përcaktimi i veprës penale si dhe kontakti me autoritetet e huaja - marrëveshje për elementin kryesor.

Punëtorja u zhvillua në formë interaktive dhe me disa raste të simuluar në praktikë për ofrimin e bashkëpunimit për arritjen e një marrëveshje mes dy e më shumë vendeve ose autoriteteve të tjera kompetente në hetimin e një veprë penale specifike.

Përfitues të këtij trajnim ishin prokurorë të Departamentit për Krime të Rënda si dhe policë hetues nga Policia Kosovës.



Masat e diversitetit

Më 11 maj 2017, Akademia e Drejtësisë me mbështetjen e UNICEF-it, ka realizuar trajnimin nga fusha penale e Drejtësisë për Fëmijë me temë “Masat e diversitetit”.

Trajnimi u realizua me qëllim që pjesëmarrësve t’iu ofroj mundësi për ngritjen e njohurive dhe shkathtësive në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore vendore, dhe familjarizimi me standardet ndërkombëtare që rrjedhin nga Konventa e OKB-së për Drejtat e Fëmijës, në drejtim të harmonizimit të praktikës gjyqësore me rastin e shqiptimit të masave të diversitetit.

Fillimisht në këtë trajnim u elaborua qëllimi i masave të diversitetit, kushtet për shqiptimin e tyre, ndaj kujt dhe për çfarë vepra penale shqiptohen masat e diversitetit, masat adekuate të diversitetit për situata specifike, llojet e masave të diversitetit dhe organet kompetente

për shqiptimin e masave të diversitetit.

Më tutje u diskutua për kufirin e moshës së përgjegjësisë penale, procedurën, mundësinë e shqiptimit të sanksionit – dënimeve apo masave ndaj fëmijës, si dhe risitë dhe ndryshimet e propozuara për Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

Trajnimi u zhvillua me diskutime interaktive nga gjyqtarët dhe prokurorët pjesëmarrës, të cilët ngritën dilemat dhe paqartësitë rreth interpretimit dhe implementimit të dispozitave në procesin e vendimmarrjes nga gjykatat, duke përfshirë edhe shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë të nivelit themelor nga Departamenti për të Mitur.



Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve në luftimin e krimit kibernetik - Sesioni I

Më 12-13 maj 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve në luftimin e krimit kibernetikë - Sesioni I”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja dhe forcimi i njohurive të pjesëmarrësve me elementet kyçe dhe tendencat e krimit kibernetik në mënyrë që të ndërtohen dhe fuqizohen kapacitetet profesionale në luftimin e kësaj dukurie negative.

Në ditën e parë të këtij sesioni trajnues u trajtua korniza ligjore që trajton krimet kibernetike, rreziqet dhe kërcënimet me të cilat përballet shoqëria në ditët e sotme nga sulmet kibernetike. Në fokus të këtij sesioni ishte shtjellimi i sistemit kompjuterik dhe mënyra e funksionimit të tij në përgjithësi, programet

kompjuterike qëllimkëqija dhe vështirësitë që hasen në gjurmimin dhe zbulimin e kryerësve të krimeve kibernetike.

Tutje gjatë këtij trajnimi u prezantuan format e kryerjes së veprave penale në fushën e krimeve kibernetike, ku sipas të dhënave të prezantuara, shënjestra kryesore e sulmeve kibernetike në Kosovë deri më sot kanë qenë llogaritë e shfrytëzuesve, sistemi bankar dhe ueb faqet në Internet.

Gjithashtu gjatë trajnimit u diskutuan edhe problemet themelore rreth ndjekjes penale, pornografia e fëmijëve si formë e veprave të kësaj natyre dhe terrorizmi kompjuterik si fenomen global.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë nga niveli themelor dhe niveli i Apelit.



Menaxhimi i stresit

Me 17 – 18 maj 2017, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme realizoi trajnimin me temë “Menaxhimi i Stresit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte aplikimi i praktikave më të mira që kanë të bëjnë me menaxhimin e suksesshëm të stresit i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatet e punës.

Në ditën e parë të këtij sesi trajnues u trajtua kuptimi dhe rëndësia e menaxhimit të kohës dhe identifikimi i elementeve të këqija të cilat ndikojnë në shtimin e stresit. Me theks të veçantë nga trajnuesit u trajtua roli i kritikave dhe opinionëve negative, përballimi i situatave kur punët shkojnë keq, efekti i punëve dhe angazhimeve të padëshiruara, pasojat e mosshfrytëzimit të pushimeve ditore, si ndikon mungesa e prioriteteve lidhur me ngarkesën e punës, si reflektohet puna që është në mospërputhje me aftësitë e një punëtori dhe efekti i shfrytëzimit të produktit të punës nga të tjerët.

Në ditën e dytë të këtij trajnimi u trajtuan stresi, stresuesit, presioni, zhgënjimi, konflikti, përshtatja si përpjekje për përballimin e stresit dhe dëshpërimet si pengesë fizike, sociale e psikologjike, që individit mund t’i zotërojë me mundim të madh ose nuk mbërrin ta zotërojë për të arritur qëllimin, me të cilin përmbush motivin e tij.

Po ashtu u diskutua edhe për ndryshimet që pasojnë sjelljet e njeriut të demoralizuar që janë ndryshime pozitive dhe ndryshime negative. Për ndryshimet pozitive – u potencua se ato kanë të bëjnë me të mësuarit e njeriut se pengesat në procesin e realizimit të qëllimeve të tij janë dukuri e rëndomtë dhe nuk është e thënë që këto pengesa të shpijnë në prapa kthesë, në mospërputhje. Ndërsa ndryshimet negative tek njeriu i demoralizuar rrjedhin nga gjendja e tij demoralizuese.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



Hetimi dhe gjykimi i rasteve me luftëtarë të huaj terrorist (LHT) në Evropën Juglindore

Më 17-18 maj 2017, Akademia e Drejtësisë në mbështetjen e Ambasadës së SHBA-ve dhe në bashkëpunim me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin – UNODC, ka realizuar trajnimin me temë “Hetimi dhe gjykimi i rasteve me luftëtarë të huaj terrorist (LHT) në Evropën Juglindore”.

Ky trajnim kishte për qëllim që të kontribuoj në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe thellimin e njohurive të pjesëmarrësve rreth çështjeve të hetimit dhe të gjyqimit të rasteve ku përfshihen luftëtarët e huaj terrorist.

Ekspert vendor dhe ndërkombëtarë gjatë trajnimit kanë trajtuar kornizën ligjore dhe praktikat vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me terrorizimin, sfidat dhe vështirësitë, elementet e veprave të luftëtarëve të huaj terrorist si dhe hetimin e veprave që ndërlidhen me luftëtarët e huaj terrorist.

Vëmendje i është kushtuar edhe bashkëpunimit

juridik ndërkombëtar, me që krimi i ka tejkaluar kufijtë e brendshëm dhe ka marrë dimension ndërkombëtarë. Si i tillë nuk mund të luftohet i vetëm në mënyrë efektive duke marrë parasysh lëvizjen e lirë të krijuar, personat udhëtojnë nga një shtet në shtetin tjetër për qëllimin e kryerjes së veprave penale, planifikimit, ose përgatitjes së pjesëmarrjes në akte terroriste. Si rezultat i kësaj, shtetet duhet të ndërmarrin masa të shtuara në parandalimin, ndërmarrjen e masave administrative, hetimin, gjykimin dhe vëmendje të veçantë duhet ti kushtohet risocializimit dhe rehabilitimit të këtyre personave pas vuajtjes së dënimit.

Trajnimi u zhvillua përmes diskutimeve interaktive, pjesë të caktuar të trajnimit janë përcjellë me video dhe rastet të ndryshme studimore.

Përfitues të këtij trajnimit ishin gjyqtarë, prokurorë të nivelit themelor dhe policë hetues nga Policia e Kosovës.



Trajtimi i rasteve të Dhunës në familje

Më 18 dhe 19 maj 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, me mbështetjen e OSBE-së ka realizuar dy trajnime regjionale të ndara me temën “Trajtimi i rasteve të Dhunës në Familje”, për regjionin e Mitrovicës dhe Prizrenit.



Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me dispozitat ligjore të Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për trajtimin e rasteve të dhunës në familje në mënyrë sa më profesionale.

Gjatë trajnimeve u elaborua mënyra e formimit të rastit në fazën e hetimeve nga policia, përfshirja e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, hetimet nga Prokurori i Shtetit si dhe faza e gjykimit. Më tej, dilemat rreth

çështjeve për të cilat gjyqtarët kanë pengesa gjatë shqyrtimit të rasteve që kanë të bëjnë me procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje për të zbatuar në mënyrë precize dispozitat ligjore lidhur me procedurën dhe afatet për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje.

Gjithashtu janë diskutuar procedurat për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje, llojet e masave mbrojtëse dhe kohëzgjatja e tyre, ekzekutimi dhe pasojat e mos ekzekutimit të urdhrit për mbrojtje.

Përmes prezantimit të rasteve nga praktika gjyqësore dhe diskutimeve grupore, pjesëmarrësve u janë ofruar alternativa për problemet dhe vështirësitë praktike në lidhje me trajtimin adekuat të rasteve të dhunës në familje.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarët, prokurorët, bashkëpunëtorët profesional, përfaqësuesit nga policia që merren me rastet e dhunës në familje si dhe mbrojtësit të viktimave nga regjioni i Mitrovicës dhe Prizrenit.



Administrimi i provave në procedurën për kundërvajtje – parimet udhëheqëse

Më 24 maj 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, nga lëmia e kundërvajtjes realizoi trajnimin me temë “Administrimi i provave – parimet udhëheqëse”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte të sqaroj në mënyrë të hollësishme administrimin e provave në procedurën për kundërvajtje, identifikimin dhe vlerësimin e provave në procedurë si dhe efektin e tyre në marrjen e një vendimi të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Në fokus të trajnimit ishin temat si: fillimi i procedurës kundërvajtëse, administrimi i provave, parimet udhëheqëse juridike gjatë administrimit të provave, kuptimi i faktit,

kuptimi i provës argumentit, provat, marrja e provës, vendi i ngjarjes, marrja në pyetje e të pandehurit, marrja në pyetje e dëshmitarit, pyetjet lidhur me faktet vendimtare, ballafaqimi, qëllimi si dhe planifikimi i ballafaqimit.

Metodologjia e trajnimit është karakterizuar edhe me punën në grupe të pjesëmarrësve. Të gjithë pjesëmarrësit janë përfshirë në debat, në prezantim të punës në grupe duke dhënë mendimin e tyre varësisht nga elementet e rastit praktik.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë nga departamenti për kundërvajtje të gjykatave themelore nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Konfiskimi ndërkufitar i pasurive

Më 25-26 maj 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin “Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtarë në Drejtësinë Penale” i financuar nga BE-ja, i zbatuar nga Rrjeti Prokurorëve të Ballkanit Perëndimor, ka realizuar punëtorinë e tretë me radhë me temë “Konfiskimi ndërkufitar i pasurive”.

Në fokus të kësaj punëtorie ishte korniza ligjore vendore dhe ndërkombëtare lidhur me administrimin dhe caktimin e pasurive të marra apo të konfiskuara me element ndërkombëtarë, përfshirë edhe metodologjinë e cila përdoret për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale.

Fillimisht nga ana e trajnuesit vendor, u prezantua një pasqyrë e gjendjes aktuale të konfiskimit të pasurive në Kosovë, për të vazhduar më tutje nga trajnuesit ndërkombëtarë elaborimin mbi zhvillimet në fushën e veprave ndërkufitare dhe konfiskimit, struktura dhe teksti i kërkesave të jashtme për ngrirjen dhe konfiskimin e pasurive, si dhe çështjet e konfiskimit në rastet e mos-dënimit. Gjithashtu, me theks të veçantë u trajtua Ligji Nr.04/L-140 për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e

Pasurisë së Përfituar me Vepër Penale, praktikave e deritanishme dhe vështirësitë e zbatimit të këtij ligji në praktikë, si dhe dallimet e kompetencave të zgjeruara mes legjislacionit vendor dhe atij gjerman, me qëllim të unifikimit të praktikave për rastet e konfiskimit të pasurive.



Punëtorija është zhvilluar përmes pjesës teorike dhe analizimit të rasteve nga praktika, si dhe punës në grupe të pjesëmarrësve.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin gjyqtarë të Gjykatës së Apelit, gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor dhe zyrtarë nga Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Njësia e Inteligjencës Financiare.



Aktakuza

Më 26 maj 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Aktakuza”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira të hartojnë si dhe të përfaqësojnë në gjykata aktin akuzues në nivelin sa më lartë profesional.



Ky trajnim ka trajtuar aktakuzën i cili është akt procedural që prokurori i shtetit e ushtron kundër kryesve të veprave penale kur ekziston dyshimi i bazuar mirë, si rezultat i hetimeve të zhvilluara. Vëmendje parësore iu kushtua

rëndësisë se këtij akti akuzues që qëndron në faktin se e vë në lëvizje procedurën penale ndaj kryerësve të veprave penale dhe i hap rrugën gjykatës që ti sanksionoj kryerësit e veprave penale.

Parapakisht gjatë trajnimit u theksua se një numër i madh i aktakuzave hedhen nga ana e gjykatës, për arsye që nuk janë konform kushteve të parapara ligjore, andaj trajtimi i kësaj teme ishte i një rëndësie të veçantë për punën e prokurorëve, për faktin që e tërë puna e tij finalizohet me ngritjen e aktit akuzues.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë në hartimin e aktakuzës cilësore e cila duhet të shoqërohet me provat e propozuara me aktin akuzues.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë të nivelit themelor.



“Referimi paragjykimor (incidental) dhe procedurat sipas nenit 113 paragrafi 8 i Kushtetutës së Kosovës”

Me 31 maj 2017, Akademia e Drejtësisë me mbështetjen e UNDP-së, ka realizuar trajnimin me temë “Referimi paragjykimor (incidental) dhe procedurat sipas nenit 113 paragrafi 8 i Kushtetutës së Kosovës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me referimin kushtetues, analizën teorike dhe normative të tij duke u përqendruar në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese si dhe të praktikës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe të gjykatave tjera kushtetuese në rajon dhe me gjerë.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtua nocioni i “referimit paragjykimor (incidental)” në doktrinën kushtetuese, subjektet e autorizuar për të referuar çështje paragjykimore dhe afatet

kohore si dhe kriteret për referim. Ndërsa në pjesën e dytë u zbërthyen efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe praktika e saj.

Në trajnim gjithanshëm u trajtua procedura e referimit kushtetues. Ky mekanizëm i kontrollit kushtetues, në teorinë e rishikimit kushtetues njihet si referim i rastit ose referim incidental. Sipas modelit të drejtësisë kushtetuese në Kosovë, gjyqtarët nuk mund të vendosin vetë për kushtetutshmërinë e një ligji, i cili është i nevojshëm për vendimin e tyre. Andaj, gjykata vetëm mund të ndërpresë procedurat gjyqësore dhe t’ia kalojë çështjen Gjykatës Kushtetuese, e cila më pas do të vendosë nëse ligji i kontestuar është kushtetues.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë të nivelit themelorë dhe bashkëpunëtor profesional.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare (PTF)

Aktivitetet e realizuara në PTF

Akademia e Drejtësisë, në drejtim të përmbushjes së programit trajnues, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, të cilin janë duke e vijuar prokurorët e shtetit të sapoemëruar.

Në kuadër të aktiviteteve të realizuara në këtë periudhë janë realizuar tre (3) sesione trajnuese nga nën-moduli “Vendi i ngjarjes dhe forenzika”, ku janë trajtuar: vendi i ngjarjes, kuptimi dhe hapat e parë që duhet ndërmarrë; sigurimi i vendit të ngjarjes dhe fazat e kryerjes së këqyrjes dhe forenzika. Po ashtu janë realizuar pesë (5) sesione trajnuese nga nën-moduli “Kontrolli dhe konfiskimi”, ku janë elaboruar: rast studimi - Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dispozitat e KPP dhe KPRK lidhur me konfiskimin dhe sekuestrimitn, Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfituruar me Vepër Penale dhe rast studimi nga praktika gjyqësore vendore.

Në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar edhe pesë (5) sesione trajnuese nga nën-moduli “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë” ku janë shtjelluar këto tema: thirrja, urdhërarrestit dhe premtimi i të

pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi i të pandehurit për t’iu afruar vendit të caktuar dhe personave të caktuar, obligimi i të pandehurit për paraqitjen më të afërt në stacionin policor dhe dorëzania, arresti shtëpiak, diversioni dhe paraburgimi.

Moduli i të drejtës kushtetuese, është realizuar përmes një (1) sesioni trajnues ku janë elaboruar burimet e së drejtës kushtetuese në Republikën e Kosovës.

Nën-moduli “Provat në procedurën penale” ka filluar, duke realizuar në këtë formë dy (2) sesione trajnuese, ndërsa sesionet tjera do të realizohen në muajin vijues. Po ashtu në këtë periudhë ka filluar trajnimi nga nën-moduli “Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore”.

Në kuadër të trajnimit praktikë, prokurorët e sapoemëruar kanë vazhduar praktikën në prokuroritë përkatëse konform orarit të përcaktuar me program, nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre, si dhe kanë vijuar trajnimet në këto institucione: Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Odën e Avokatëve të Kosovës, Shërbimin Sprovues të Kosovës, dhe Institucionin e Avokatit të Popullit.



Trajnimi praktik në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Më 03 maj 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka realizuar trajnimin praktikë për prokurorët e sapoemëruar të cilët janë duke vijuar trajnimin në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar.

Qëllimi i trajnimit ishte që prokurorët e sapoemëruar të thellojnë njohuritë për parimet, rolin dhe fushëveprimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Gjatë trajnimit fillimisht u pasqyrua një historik i shkurtër i themelimit dhe zhvillimit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, baza ligjore dhe struktura organizative, mbi të cilat ushtron fushë-

veprimtarinë e saj. Më tej, trajnimi u fokusua në elaborimin e çështjeve që ndërlidhen me të drejtat e subjektit të të dhënave, të dhënat personale të ndjeshme, transferimi i të dhënave personale, si dhe detyrat dhe roli i Zyrtarit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili funksionon në kuadër të institucioneve tjera.

Qasja e zyrtarit nga ASHMDHP ishte karakterit interaktiv me ç' rast prokurorët e sapoemëruar, kishin hapësirën për të paraqitur dhe diskutuar për çështjet e interesit të përbashkët.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së VI të PTF-së.



Trajnimi praktik në Odën e Avokatëve të Kosovës

Më 10 maj 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, ka mbajtur trajnimin e radhës për prokurorët e sapoemëruar në Odën e Avokatëve të Kosovës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte t'i informoj prokurorët e sapoemëruar rreth formave të organizimit të brendshëm dhe funksionimit të Odës së Avokatëve të Kosovës si një organizatë e pavarur me karakter publik.

Fillimisht, kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës, prezantoi bartësit e detyrave në administratës së Odës së Avokatëve të Kosovës, duke takuar secilin, me ç' rast diskutuan dhe prezantuan funksionet dhe detyrat që kryejnë.

Më tej, trajnimi vazhdoi në qendrën trajnuese për avokatë, me ç' rast u trajtua legjislacioni/baza juridike e krijimit dhe funksionimit,

organet dhe degët regjionale si dhe kompetencat e Këshillit Drejtues dhe të Kryetarit të Odës së Avokatëve. Po ashtu, u elaborua roli dhe funksionimi i Qendrës Trajnuese për avokatë si dhe programet trajnuese që ajo ofron.

Prokurorët e sapoemëruar, në pjesën e fundit të trajnimit, u ndanë në grupe punuese, dhe punuan në një rast praktik nga Etika Profesionale.

Trajnimi ishte interaktiv, me ç' rast nga prokurorët e sapoemëruar u ngritën diskutime dhe u parashtruan pyetje lidhur me çështjet e interesit të përbashkët.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar, gjenerata e VI e PTF-së.



Trajnimi praktik në Shërbimin Sprovues të Kosovës

Më 17 maj 2017, në kuadër të trajnimeve praktike në institucionet jo-gjyqësore, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Shërbimin Sprovues të Kosovës, ka realizuar trajnimin për prokurorët e sapoemëruar për këtë institucion.

Qëllimi i trajnimit konsistonte në faktin që prokurorët e sapoemëruar të thellojnë njohuritë e tyre lidhur me mandatin, strukturën organizative dhe punën praktike që zhvillon Shërbimi Sprovues i Kosovës.

Zyrtarë të deleguar nga Shërbimi Sprovues i Kosovës, fillimisht paraqitën një historik të shkurtër të krijimit dhe zhvillimit të SHSK-së, kornizën ligjore mbi bazën e të cilës ata

ushtrojnë mandatin e tyre, dhe strukturën organizative, duke përfshirë rolin dhe organizimin e Drejtorisë Qendrore dhe Zyrave Regionale të SHSK-së. Më tej u paraqitën statistika të lëndëve të përpunuara nga SHSK në përgjithësi, duke trajtuar aspekte krahasuese, për kategoritë të ndryshme, gjatë viteve të fundit. Po ashtu, në kuadër të këtij trajnimi u shtjellua bashkëpunimi aktual i SHSK-së me prokuroritë dhe institucionet tjera, me ç' rast prokurorët e sapoemëruar, bashkërisht me zyrtarët e SHSK-së, diskutuan rreth mundësive të bashkëpunimit reciprok në të ardhmen.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së VI të PTF-së.



Trajnimi praktik në Institucionin e Avokatit të Popullit

Më 24 maj 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit, ka organizuar trajnimin në këtë institucion, për prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së IV të PTF-së.

Qëllimi i trajnimit ishte që prokurorët e sapoemëruar të krijojnë një pasqyrë të qartë rreth mandatit, rolit, strukturës organizative dhe sfidave me të cilat ballafaqohet IAP.

Fillimisht, nga Avokati i Popullit, u pasqyrua një historik i shkurtër i themelimit dhe zhvillimit të institucionit të Avokatit të Popullit, korniza ligjore dhe kompetencat e IAP-së sipas legjislacionit të zbatueshëm, mbi të cilin ky institucion ushtron mandatin e tij, si dhe sfidat e përgjithshme me të cilat ata ballafaqohen, duke përfshirë vështirësitë që hasen në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe respektimin e rekomandimeve që jep IAP në drejtim të institucioneve publike.

Me tej, u elaborua procedura e brendshme e shqyrtimit të ankesave që paraqiten në IAP, duke përfshirë edhe ankesat e qytetarëve drejtuar ndaj gjyqësorit, puna e Mekanizmit Kombëtarë për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese, si dhe relacioni i Institucionit të Avokatit të Popullit me sistemin gjyqësor dhe prokurorial.

Prokurorët e sapoemëruar, gjatë realizimit të këtij trajnimi kishin mundësinë që të jenë diskutojnë dhe shtrojnë pyetje rreth çështjeve që ndërlidhen me punën e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe punës së prokurorisë. Në këtë kuadër, ata të ndarë në grupe punuan në një rast praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorët e sapoemëruar të gjeneratës së VI të PTF-së.



Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime

Tryezë pune me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit

Më 17-18 maj 2017, Akademia e Drejtësisë me mbështetjen e UNDP-së, ka realizuar tryezën e punës me gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për të shqyrtuar praktikën e Gjykatës së Apelit, veçanërisht çështjet civile të natyrës procedurale dhe materiale, ku gjykatat e shkallës së parë dështojnë të nxjerrin një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.



Kjo tryezë kishte për qëllim që të kontribuoj në ndryshimin e trendit të lëndëve të cilat kthehen në rishqyrtim përmes një udhëzuesi apo

përmbledhje e cila do të rezultojë pas hulumtimit dhe identifikimit të çështjeve problematike nga grupi i gjyqtarëve të cilët janë angazhuar në këtë projekt hulumtues.

Për dy ditë me radhë gjyqtarët nga këto departamente prezantuan individualisht rastet më të shpeshta që vijnë nga gjykatat e shkallës së parë të cilat për shkak të shkeljeve qoftë procedurale dhe materiale duhet të kthehen në rishqyrtim. Me këtë rast edhe u identifikuan temat që do të trajtohen në vijim në një dokument, cili do t'iu shërbejë gjyqtarëve të shkallës së parë si referencë me rastin vendosjes së rasteve.

Në këtë tryezë morën pjesë kryetari i Gjykatës së Apelit dhe gjyqtarë tjerë nga Departamenti i Përgjithshëm - divizioni civil, Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti për Çështje Ekonomike.



Aktivitetet tjera

Shkrimi dhe arsyetimi ligjor

Më 19 maj 2017, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive, ka organizuar trajnimin, me temë “Shkrimi dhe arsyetimi ligjor”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte të pjesëmarrësve në hartimin e vendimeve të ndryshme ligjore si dhe sigurimi i qasjes dhe standardeve të unifikuara për hartimin e të gjitha llojeve të akteve dhe dokumenteve të gjykatave dhe prokurorive.

Në fokus të trajnimit ishte hartimi i dokumenteve të qarta, të logjikshme dhe të përmbledhura mirë, që bazohen në metodën IRAC, si një metodë e thjeshtë dhe logjike për zgjidhjen e çështjeve ligjore për të komunikuar arsyetimin ligjor në mënyrë verbale dhe me

shkrim, gjatë të gjitha fazave të procedurës gjyqësore.

Gjatë këtij trajnimi u elaboruan llojet e akteve, dokumenteve dhe kumtesave të gjykatave, prokurorive dhe procedurat për elaborimin e tyre, standardet, format dhe procedurat e zbatueshme - analiza e mangësive, puna me lëndë, mbajtja e shënimeve, rrjedha e komunikimit dhe raportimit, si dhe rëndësia e përdorimit të gjuhës së saktë dhe standardit të korrespondencës zyrtare.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive duke shtjelluar edhe raste të ndryshme nga praktika gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive të niveleve të ndryshme.



Punëtori për hartimin e akteve normative të Akademisë

Me 22, 23 dhe 24 maj 2017, Akademia e Drejtësisë realizoj punëtorinë për hartimin e akteve normative obligative që dalin si rezultat i hyrjes në fuqi të Ligjit për Akademinë e Drejtësisë.

Gjatë kësaj punëtorie, Komisioni së bashku me grupin punues nga staf i Akademisë, identifikuan aktet normative të përcaktuara sipas Ligjit për Akademinë e Drejtësisë dhe fillimisht u përcaktuan në hartimin e akteve të para si në vijim: Rregulloren për punën e Këshillit Drejtues, të Akademisë, Rregulloren e Programit të Trajnimit Fillestar si dhe Rregulloren për Trajnuesit dhe Mentorët.

Aktet tjera të cilat i përcakton ky ligj u vendosë që të jenë në fokus të punëtorisë së

radhës me qëllim të respektimit të afatit kohor të përcaktuar sipas ligjit.

Pas analizimit dhe diskutimeve të shumta, me rastin e hartimit të këtyre akteve, komisioni mori për bazë parimet dhe standardet për hartim të normave juridike me qëllim të funksionimit sa më të mirë dhe zbatimit praktik të tyre.

Aktet që u finalizuan dhe të cilat do të dërgohen për miratim në Këshillin Drejtues të Akademisë janë Rregullorja për punën e Këshillit Drejtues dhe Rregullorja e Programit të Trajnimit Fillestar. Ndërkaq, drafti i Rregullores për Trajnues dhe Mentorë mbetet për tu plotësuar në punëtorinë e radhës.



Avancimi i performancës në administrimin e sistemit prokurorial

Me 30 – 31 maj 2017, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Këshillin Prokurorial të Kosovës realizuan trajnimin me temë “Avancimi i performancës në administrimin e sistemit prokurorial”.

Qëllimi i trajnimit ishte vetëdijesimi i përfituesve lidhur me konceptet e reja të menaxhimit të përvetësuar me frymën e ndryshimeve ligjore dhe ristrukturimin e Sekretariatit të Këshillit Prokurorial e që ka krijuar një vizion të ri për procesin e hartimit të politikave dhe ofrimin e shërbimeve në kuadër të sistemit prokurorial.

Përmes punës në grupe dhe diskutimeve u elaboruan parimet si qasja proaktive në ofrimin e shërbimeve dhe planifikimi në kohë, efektiv dhe efikas përfshirë edhe diskutimet

për propozim të politikave për avancimin e administrimit efikas të sistemit prokurorial.

Për më tepër, në fokus të trajnimit ishte edhe avancimi i mëtejshëm i sistemit të vlerësimit të performancës i cili paraqet një prej aspekteve kryesore në administrimin efikas të sistemit të drejtësisë dhe që ndikon drejtpërdrejt në llogaridhënie dhe në motivimin e personelit për ofrimin e shërbimeve cilësore.

Përfituesit e këtij trajnimi ishin udhëheqësit e njëjësive organizative të Sekretariatit (departamenteve, divizioneve dhe zyrave) si dhe administratorët e prokurorive.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**